



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

RAPORTIMI VJETOR MBAJTUR PËRPARA
KOMISIONIT PARLAMENTAR TË EKONOMISË

Mbi
veprimtarinë e AMF-së
gjatë vitit 2011

PËRMBLEDHJE E VEPRIMTARISË SË AMF-SË - 2011

Të nderuar deputetë,

kam nderin të paraqes sot përpara jush një përmbledhje të veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) gjatë vitit 2011 dhe projekteve më të rëndësishme, në funksion të përballimit me sukses të sfidave të zhvillimit të tregjeve financiare jo-bankare.

AMF, si rregullator i integruar në fushat e sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private vullnetare, vjen sot pas një pune intensive 5 vjeçare në kuadrin e një programi afatmesëm me produkte konkrete në fushën rregullatore, mbikëqyrëse, të teknologjisë së informacionit, atë kooperuese e konsolidimit institucional.

Viti 2011, ishte një vit me arritje të rëndësishme në drejtim të kuadrit rregullues dhe legjislativ për mbikëqyrjen e tregjeve nën juridiksionin e AMF-së, duke e vënë theksin tek Metodologjia e Mbikëqyrjes me Fokus Riskun për tregun e sigurimeve.

Veprimtaria e AMF-së është udhëhequr nga misioni i saj themelor, që është të **kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të sigurt të tregut financiar jo-bankar.**

Zhvillimet në tregun financiar jo-bankar, gjatë vitit 2011, kanë shënuar një sërë ndryshimesh të rëndësishme si sasiore ashtu edhe cilësore. Viti 2011 konkretizoi një sërë projektesh dhe nismash të rëndësishme që nga krijimi i institucionit, të tilla si:

- Metodologjia e re e mbikëqyrjes me fokus riskun e mbështetur nga platforma elektronike e raportimit AMF In-Reg;
- Miratimi i një sërë akteve nënligjore;
- Licencimi i shoqërive të para administruese të fondeve të pensionit dhe investimit;
- Përgatitja dhe licencimi i profesionistëve e ndërmjetësve të ndryshëm financiarë;

- Investime në ndërtimin e sistemit të shkëmbimit të të dhënave në mënyrë automatike me Ministrinë e Brendshme dhe me Ministrinë e Transportit, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, paraprirë nga nënshkrimi i Marrëveshjeve tepër të rëndësishme të Bashkëpunimit me këto dy institucione;
- Forcimi i bashkëpunimit me institucionet homologe në rajon dhe institucionet brenda vendit;
- Inaugurimi i mjediseve të reja të AMF-së,
të cilat kanë konturuar ngritjen e një institucioni të ri, pas një sërë zhvillimesh pozitive dhe një pune të suksesshme, e vlerësuar dhe nga Ju, që nga krijimi i tij në tetor të vitit 2006.

Të nderuar deputetë,

Gjatë vitit 2011, tregu i sigurimeve pati vëmendjen kryesore dhe fokusimin e pjesës më të madhe të burimeve dhe kapaciteteve të AMF-së, nisur jo vetëm nga pesha kryesore në tregun financiar jo-bankar në Shqipëri, por edhe nga një sërë zhvillimesh e projektsh të rëndësishme, që u konkretizuan.

Duke u mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi dhe në respektim të funksioneve të veta, Autoriteti ka analizuar dhe mbikëqyrur veprimtarinë e sektorit të sigurimeve. Kështu, është shqyrtuar kryesisht pozicioni financiar, rezultatet dhe treguesit teknikë të veprimtarisë së tregut të sigurimeve dhe të shoqërive të sigurimit në veçanti. Si përparësi në ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes kanë qenë përmirësimi i procesit të mbikëqyrjes së këtij tregu dhe ruajtja e interesave të të siguruarve.

Raporti i depozituar në Kuvend në muajin shkurt 2012, për pjesën e analizës financiare është bazuar në masë të madhe në të dhënat e tregut për 9 mujorin e vitit 2011, ndërsa të dhënat statistikore i përkasin periudhës janar-dhjetor 2011.

Shifrat dhe faktet për vitin 2011, tregojnë për një treg të **qëndrueshëm** e të mirë kapitalizuar, **me një strukturë tashmë më të diversifikuar dhe të balancuar.**

- Penetrimi i sigurimeve gjatë 2011 ishte 0.67%. Ky raport ilustron faktin se tregu i sigurimeve ka ende shumë potencial për rritje të mëtejshme drejt maturimit dhe synimit minimalisht të niveleve të krahasueshme me rajonin.
- Gjatë vitit 2011 vijuan të ushtrjnë veprimtarinë dhjetë shoqëri sigurimi, nga të cilat shtatë shoqëri të sigurimit të Jo-Jetës, dy shoqëri të sigurimit të Jetës dhe një shoqëri kompozite e Jetës dhe Jo-Jetës. Pesë shoqëri sigurimi kanë pronësi vendase, ndërsa pesë të tjerat kanë pjesëmarrje influencuese të huaj.
- Gjatë vitit 2011, industria shqiptare e sigurimeve vazhdoi të njohë rritje, megjithëse me një ritëm më të ulët se viti i kaluar. Në vitin 2011 tregu i sigurimeve ka patur një rritje prej afro 2% për primet e shkruara bruto, krahasuar kjo me një vit më parë. Rritja e tregut të sigurimeve për vitin 2011 është nxitur kryesisht nga dinamika e rritjes së sigurimeve vullnetare dhe veçanërisht nga sektori i Jetës, i cili tashmë zë 13% të totalit të primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve.
- Ndikim në rritjen e frenuar të tregut ka patur sigurimi i detyrueshëm motorik dhe konkretisht portofoli MTPL e brendshme, i cili është ulur me gati 25% krahasuar me vitin 2010 edhe pse numri i kontratave shënoi rritje në masën 6%. Ulja e menjëhershme e çmimeve nga operatorët, pas heqjes me ligj të tarifave fikse, i ka shkaktuar tregut një rritje të munguar prej afro 11%.
- Gjatë vitit 2011, evidentohet përsëri dinamika e lartë e rritjes së sigurimeve vullnetare (17%), duke shënuar për herë të parë një përmbyse të strukturës së tregut, në favor të sigurimeve vullnetare. (55% / 45%)
- Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, portofolet me peshë specifike më të lartë janë zjarri dhe dëmtimet në pronë me rreth 34%, të pasuara nga sigurimi i aksidenteve dhe i shëndetit me rreth 25% dhe sigurimi kasko me rreth 18%.
- Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës për vitin 2011, krahasuar me një vit më parë patën një rritje prej 26% (nga 18% që ishte në vitin 2010), rritje kjo që lidhet kryesisht me nivelin e kreditimit për individët, ku përfituese janë bankat e nivelit të dytë. Kështu, portofoli “Jetë Debitori” ka kontribuar në

masën 66% të kësaj rritje, shoqëruar dhe me një rritje të numrit të kontratave të këtij portofoli në masën 21%.

- Futja e investitorëve të huaj në treg këto vitet e fundit, ka patur ndikimet e veta pozitive në drejtim të prezantimit të një game të re produktesh vullnetare. Vlen të theksohet, se sigurimi i aksidenteve dhe i shëndetit është linja më dinamike e tregut të sigurimit me një rritje prej 91% për primet e shkruara bruto, krahasuar me vitin 2010. Faktorët që kanë ndikuar në këtë dinamikë pozitive janë rritja në veçanti e volumit të primeve të sigurimit të shëndetit privat, produkt i cili është nxitur vitet e fundit nga ekspertiza austriake në treg.
- **Pavarësisht zhvillimeve pozitive, niveli i ulët i penetrimit dhe raporti i ulët dëme prime (31% në nëntëmujorin 2011), faktojnë sfidat e tregut të sigurimeve në drejtim të rritjes së besimit të konsumatorit dhe përmirësimit të shërbimit.**
- Numri i automjeteve të pasiguruara vlerësohet të jetë i lartë, duke rënduar kostot e sistemit dhe në veçanti të shoqërive të sigurimit. Nga një vlerësim i pagesave aktuale për vitin 2011 të dëmeve nga Fondi i Kompensimit, efekti në raportin dëme/prime të tregut do të ishte 4% më tepër (duke e çuar nga 31% në 35%). Përsa i përket financimit të skemës së fondit të kompensimit nga gjobat e vjela nga automjetet e pasiguruara, pavarësisht rregullimit në legjislacionin përkatës, në praktikë ky rregullim nuk ka gjetur zbatim.

Viti 2011 ka qenë i rëndësishëm në drejtim të nxitjes së mëtejshme të veprimtarisë së **Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar**, sipas dispozitave të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. AMF ka bashkëpunuar me **Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave dhe Agjencinë e Sigurimit të Depozitave** në drejtim të formalizimit të nivelit të bashkëpunimit ndërmjet këtyre institucioneve, në kuadër të përmbushjes së objektivave respektive për zhvillimin e sistemit financiar në vend dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë së tij.

Me asistencën e Bankës Botërore, është konkretizuar nisma e përbashkët, për përgatitjen dhe firmosjen e një memorandumi bashkëveprimi ndër institucional, i cili do të harmonizojë dhe bashkërendojë në mënyrë formale veprimet e

institucioneve në fjalë, duke ndihmuar në monitorimin dhe administrimin me efikasitet të situatave të jashtëzakonshme financiare, me qëllim kryesor ruajtjen e qëndrueshmërisë e stabilitetit financiar të vendit.

Mbikëqyrja e tregut të sigurimeve përfshin raportimin e saktë dhe në kohë të pasqyrave teknike e financiare, analizën e informacionit të marrë mbi aktivitetin e shoqërive të sigurimit, si dhe inspektimin në vend të këtyre shoqërive.

Analiza e thelluar financiare është kryer përmes vlerësimit të pozicionit financiar, rezultateve teknike dhe financiare të veprimtarisë së shoqërive të sigurimit, mbështetur në të dhënat e raportimit periodik të këtyre shoqërive në Autoritet, informacioneve shtesë të depozituara nga këto shoqëri ose institucione të tjera, si dhe mbi gjetjet e inspektimit në vend. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar kërkesave për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe provigjoneve teknike. Autoriteti vlerëson nëse provigjonet teknike, të cilat përfaqësojnë detyrimet ndaj të siguarve, janë të mjaftueshme dhe mbulohen jo më pak se vlera bruto e tyre me aktive të përshtatshme në çdo kohë. Shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të kenë mjaftueshmëri kapitali në çdo kohë.

AMF e realizon funksionin e vet mbikëqyrës nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit rregullativ mbikëqyrës në përputhje me parimet ndërkombëtare dhe direktivat evropiane, ndërmarrjes së politikave zhvilluese për tregun, trajnimit të burimeve njerëzore drejt një mbikëqyrje efektive, etj.

Kështu, në mbledhjen e datës 6.10.2011, Bordi i AMF-së miratoi metodologjinë e re të mbikëqyrjes me fokus riskun në sigurime, nëpërmjet miratimit të Manualit të Mbikëqyrjes me Fokus Riskun, së bashku me planin strategjik të zbatimit.

Në vijim të punës së nisur prej 3 vjetësh, AMF konkretizoi në këtë mënyrë një nga nismat më të rëndësishme në drejtim të forcimit të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve, që nga krijimi i institucionit.

Mbikëqyrja efektive është konceptuar në tre shtylla kryesore:

- Manuali i mbikëqyrjes me fokus riskun:

Koncepti bazë i metodologjisë së re është të identifikojë zonat me rrezik më të lartë në veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit dhe kur është e nevojshme, të punojë me menaxhimin e saj në mënyrë që ta ulë riskun në nivele të pranueshme. Objektivi është që problemet financiare të parandalohen përpara se të ndodhin, në vend që të punohet për zgjidhjen e tyre pasi ato të kenë ndodhur. Sipas metodologjisë së re, vëmendje më e madhe do t'i kushtohet operatorëve që paraqesin risk më të lartë, duke përqendruar dhe energjitë në fushat me risk më të lartë. Në këtë mënyrë, AMF përcakton qartë drejtimit e saj strategjike për forcimin e mëtejshëm të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve, duke u afruar përherë e më tepër me standardet më të mira të fushës dhe duke përqafuar tendencat globale të rregullimit në fushën e sigurimeve.

- Kuadri ligjor, projektligji i sigurimeve dhe risigurimeve, në mbështetje të metodologjisë së re:

Baza e re ligjore krijon hapësirat e nevojshme për zbatimin e mbikëqyrjes me fokus riskun, duke vendosur gjithashtu kërkesa të forta për qeverisjen e shoqërive, menaxhimin e riskut e deri tek shkallët e ndërhyrjes nga Autoriteti sipas niveleve të riskut. Për herë të parë, në këtë ligj është futur dhe koncepti i mbikëqyrjes së grupeve të sigurimit.

- Ngritja e një platforme moderne teknologjie informacioni për raportimin e tregut në Autoritet, AMF In-Reg:

Ky projekt tre vjeçar është zhvilluar me ndihmën financiare të Bankës Evropiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH) dhe i mundëson subjekteve të mbikëqyrura raportim të të dhënave të kërkuara nga Autoriteti në mënyrë elektronike nëpërmjet faqes së internetit. Sistemi është testuar me sukses gjatë vitit 2011 dhe ka patur disa përmirësime të vazhdueshme cilësore. Krahas mënyrës së raportimit është rikonceptuar dhe paketa e raportimit të shoqërive të sigurimit në linjë me metodologjinë e re të mbikëqyrjes me bazë risku. Synimi i AMF-së është që në vitin 2013 raportimi i subjekteve të mbikëqyrura të zhvendoset tërësisht nëpërmjet sistemit AMF In-Reg, duke e vendosur AMF-në në një pozicion me disa rregullatorë modernë që zbatojnë sisteme të ngjashme.

Gjatë vitit 2011 janë zhvilluar aktivitete, me qëllim bashkëpunimin ndërinstitucional dhe në përmbushje të nevojave të mbikëqyrjes së tregut, operatorëve të tij dhe mbrojtjes së konsumatorëve. Në zbatim të “Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Shkëmbimit të Informacionit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe akteve të tjerë dypalëshe në kuadër të saj, Autoriteti në bashkëpunim edhe me partnerët, gjatë vitit 2011 ka projektuar dhe ndërtuar sisteme, të cilët ndërthurin infrastrukturën ekzistuese me kërkesat e ndërsjellta institucionale. Të tilla kanë qenë shërbimi mbi raportimin e dëmeve për “Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor”, DPSHTRr, shërbimi mbi kontrollin në kohë reale të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik nga “Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit” si dhe shërbimi mbi kontrollin e policave të sigurimit të detyrueshëm motorik nga “Njësia e Kontrollit të Autostradave”.

Shërbimet e mësipërme janë rezultat i bashkëpunimit të frytshëm edhe me Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) i shprehur përgjatë vitit 2011 me kurorëzimin e pjesëmarrjes së Autoritetit në rrjetin kompjuterik ndërinstitucional GovNet.

AMF, në funksionin e mbikëqyrjes në vend, ka kryer 22 inspektime në vend gjatë vitit 2011, në të tre sektorët e mbikëqyrur.

Gjatë 2011, AMF, në kuadër të bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë, ka kryer inspektim të përbashkët tematik në bankat e nivelit të dytë, me qëllim verifikimin në vend të kontratave të garancisë dhe të kreditit të lëshuara nga shoqëritë e sigurimit, për të evidentuar përfituesin dhe kushtet e kontratave, me qëllim përcaktimin e klasës së sigurimit, si dhe verifikimin në vend të të gjitha vlerave monetare të shoqërive të sigurimit, të vendosura në bankë, për t’u ruajtur gjatë vitit, me destinacion qëllimor.

Po kështu, në kuadër të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit, në mars 2011, AMF me kërkesë të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve (AMS), Maqedoni, mori pjesë në një inspektim të përbashkët të organizuar nga homologët maqedonas, në një nga shoqëritë e sigurimit që operojnë në Maqedoni. Ky

inspektim i shërbeu kryesisht shkëmbimit të eksperiencave dhe praktikave të vendeve respektive, si edhe forcimit të bashkëpunimit reciprok midis dy rregullatorëve në fushën e sigurimeve.

Në shtator 2011, në kuadër të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve, AMF ka kryer një inspektim të përbashkët me **Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit** bazuar në “Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, datë 31.03.2011, nënshkruar midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, **Ministrit të Brendshme dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit**. Qëllimi i këtij inspektimi është mundësimi i kontrollit të zbatimit të legjislacionit për sigurimin e detyrueshëm, evidentimit të saktë dhe pajisjes së mjeteve motorike me kontrata sigurimi të vlefshme, zvogëlimit të numrit të mjeteve të transportit të pasiguruara, kontrolleve të përbashkëta dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme të qarkullimit të mjeteve motorike.

Mbështetur në gjetjet, problematikën apo mangësitë e konstatuara nga inspektimet në tërësi, Bordi i AMF-së, mori vendime që kishin të bënin me marrjen e masave apo vendosjen e sanksioneve ndaj shoqërive të sigurimit, si dhe me dhënien e rekomandimeve, me qëllim përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit.

Gjatë vitit 2011, Bordi i Autoritetit ka vendosur për shoqëritë e sigurimit: 9 masa korigjuese, 11 urdhra për eliminim shkelje, 1 sanksion me gjobë, 1 plan masash financiare, 3 paralajmërime për tërheqje licence, 1 tërheqje licence agjenti në sigurime dhe 6 tërheqje licence për vlerësues dëme në sigurime.

Tregu i letrave me vlerë:

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë është segmenti më aktiv në tregun e letrave me vlerë në Shqipëri, ndërsa tregu i aksioneve vazhdon të mbetet ende i pazhvilluar. Pavarësisht përpjekjeve, viti 2011 nuk shënoi ndonjë zhvillim të veçantë në aktivizimin e Bursës.

Në tregun me pakicë të letrave me vlerë operojnë tashmë 9 (nëntë) operatorë të licencuar për të ushtruar veprimtarinë në këtë treg, pas licencimit të dy operatorëve të rinj, “Tirana Bank” dhe “First Investment Bank”.

Në tregun e letrave me vlerë operojnë gjithashtu 13 shoqëri brokerimi, nga të cilat 9 janë banka. Autoriteti ka autorizuar 8 banka për të kryer veprimtarinë e kujdestarit të letrave me vlerë të qeverisë së R.Sh.

Viti 2011 shënoi vitin e pestë të menaxhimit nga AMF në mënyrë të suksesshme të platformës GSRM. Kjo platformë vazhdon të funksionojë, me qëllim që të sigurojë rritjen e transparencës në lidhje me kuotimet dhe transaksionet në tregun me pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë, duke synuar mbrojtjen më të mirë të interesave të investitorëve. Platforma GSRM jep një informacion të plotë dhe të përditësuar për publikun dhe investitorët institucionale, në lidhje me kërkesat dhe ofertat ditore në këtë treg.

Tregu i pensioneve private vullnetare mbetet ende një treg i vogël por ndër zhvillimet risi gjatë vitit 2011 në këtë treg, në aspektin licencues, ka qenë licencimi i shoqërive të para administruese të fondeve të pensionit vullnetar, në zbatim të Ligjit “Për fondet e pensionit vullnetar”. Gjithashtu, për herë të parë, në mbështetje të ligjit të ri të fondeve të pensionit vullnetar, janë licencuar dhe një sërë bankash për të kryer veprimtari depozitimi të aseteve të fondeve të pensionit vullnetar. Aktualisht, në treg operojnë tri shoqëri administruese të fondeve të pensioneve vullnetare, të cilat përkatësisht kanë nën administrim nga një fond pensioni. Në funksion të veprimtarisë së shoqërive administruese dhe detyrimeve ligjore, janë licencuar 3 banka në rolin e depozitarit (nga të cilat 1 në vitin 2011 dhe 2 në vitin 2010).

Licencimi sipas standardeve evropiane i operatorëve të rinj në këtë treg, pritet të luajë një rol të rëndësishëm në maturimin e tij, duke rritur më tej besueshmërinë e publikut në investimin e fondeve në skemën e pensioneve private vullnetare. Për më tepër, përfshirja e lehtësirave tatimore në këtë ligj, të cilat synojnë ta bëjnë skemën e pensionit privat më tërheqëse për kontribuesit dhe punëdhënësit, nuk kanë gjetur ende zbatim.

Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare deri në 30.09.2011, tregon një total asetesh nën menaxhim prej 142 milion lekë dhe të ardhura neto nga investimet prej afro 6 milion lekë. Numri i anëtarëve gjithsej që janë të regjistruar deri më 31 dhjetor 2011 në këto fonde është 6,295 anëtarë me një rritje në masën 26% nga viti 2010.

Aktiviteti rregullues

Aktiviteti rregullues përbën shtyllën e dytë kryesore për AMF-në. Plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor e rregullator përbën për AMF-në një prioritet të natyrës afatgjatë. Tregu financiar jo-bankar në vend, në vijimësi, po përballet me aktivitete e produkte të reja për mbikëqyrjen e të cilave kërkohet plotësimi dhe përshtatja e kërkesave rregullatore. Përveç kësaj, aktiviteti rregullues po intensifikohet si rrjedhojë e procesit të integritimit në BE dhe kërkesave për përafrim të legjislacionit. Gjatë vitit 2011 vëmendja kryesore është përqendruar në plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit rregullator. Hyrja në fuqi në periudhën 2009-2010 e ligjeve të rëndësishme për “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”; “Për fondet e pensionit vullnetar”; “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”; “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore” si dhe “Për marrjen e paketës kontrolluese të shoqërive publike”, diktoi një proces dyvjeçar hartimi dhe përmirësimi të akteve rregullative. Gjatë vitit, në AMF, janë hartuar 22 rregullore të reja, si dhe janë kryer ndryshime në disa rregullore të tjera të mbikëqyrjes financiare jo-bankare.

Aktet e reja rregullative kanë të bëjnë me:

- Sistemin dhe procedurat e raportimit nga subjektet e mbikëqyrura si për raportimin në sistemin In-Reg për shoqëritë e sigurimit, raportimin e shoqërive administruese të fondeve të pensionit apo të investimeve kolektive, shoqërive të administrimit dhe të depozitarëve;
- Mbikëqyrjen nëpërmjet përcaktimit të niveleve të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit; përcaktimit të vlerës dhe të vlerës neto të aseteve të sipërmarrjeve të investimit kolektiv; përmbajtjen e kontratës dhe të prospektit të fondit të pensionit;

- Licencimin dhe mbikëqyrjen e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike të krijuar nga një shoqëri e huaj administrative; licencimin e depozitarëve të këtyre sipërmarrjeve të investimeve kolektive, si dhe kriteret për mbylljen e fondeve të investimeve;
- Autorizimin e individëve për shitjen e kuotave apo aksioneve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike;
- Miratimin e kodit të sjelljes së shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive;
- Regjistrat e sipërmarrjeve apo të investitorëve të investimeve kolektive;
- Delegimin e funksioneve të shoqërisë administruese të fondeve të pensioneve, si dhe për ndarjen e veprimtarive të shoqërisë administruese të fondit të pensionit vullnetar.

Pavarësisht se gjatë vitit 2011 nuk u miratua ndonjë ligj i ri, në AMF është punuar intensivisht për hartimin dhe miratimin e **projektligjit të ri mbi veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve**. Ky dokument, që pritet të miratohet në **2012**, do të krijojë hapësirat e nevojshme ligjore për zbatimin e metodologjisë së re të mbikëqyrjes me fokus riskun. Aktualisht projektligji është në proces diskutimi me palët e interesit, dhe miratimi i tij do të shoqërohet me një tjetër paketë të konsiderueshme rregulloresh që do të përgatiten nga AMF këtë vit dhe në vitin në vijim.

Gjej rastin të nderuar deputetë, të përshëndes kontributin tuaj të deritanishëm në miratimin e ligjeve të fushës financiare jo-bankare duke kërkuar mbështetjen tuaj për miratimin gjatë këtij vitit të projektligjit për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve, si dhe të amendimeve në ligjin për AMF-në.

Aktiviteti licencues

Në ushtrimin e kompetencave të veta në procesin licencues, AMF udhëhiqet nga parimi i standardizimit të procedurave dhe njëtrajtshmërisë së zbatimit të tyre për veprimtari të ngjashme. Nga ana tjetër, kërkesat dhe procedurat e licencimit të zbatuara është synuar të formulohen me qartësi, objektivitet dhe transparencë.

Kriza financiare botërore e vitit 2008 ka rritur vëmendjen në aspektet e gjendjes së shëndoshë financiare të aplikantit, forcimit të strukturës qeverisëse të tij, si dhe të forcimit të aftësive profesionale dhe cilësive etike, duke ndikuar edhe në qasjen e rregullatorëve financiarë. Për rrjedhojë, në praktikën licencuese të AMF-së gjatë vitit 2011 është përforcuar prirja e vlerësimit të elementëve të aftësisë profesionale dhe etikës, si dhe sigurimit të strukturave qeverisëse bazuar në praktikat më të mira.

Veprimtaria licencuese ushtrohet në tri tregje: të sigurimeve, të titujve dhe të pensioneve. Për shkak të shkallëve të ndryshme të zhvillimit të secilit treg, pritet që veprimtaria licencuese të jetë më e përqendruar në licencimin e subjekteve të reja të fushës së titujve dhe të pensioneve, si dhe të licencimit të profesionistëve apo ndërmjetësve.

Në vitin 2011 janë shënuar disa risi në procesin licencues. Kështu:

- U licencua shoqëria “Raiffeisen Invest-Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive”, e cila administron fondin e investimit “Raiffeisen Prestigj”, të miratuar po në vitin 2011. Krahas me të u licencua dhe shoqëria “First Investment Bank - Albania” sh.a. për të vepruar si Depozitar i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive.
- U miratua prospekti i paraqitur nga shoqëria “Banka Credins” sh.a, që përbën ofertën e parë private për emetim obligacionesh nga një shoqëri aksionare.
- U miratua licenca paraprake e një shoqërie të re sigurimi, treg në të cilin prej vitit 2004 nuk kishte patur zhvillime të tilla. Aktiviteti i shoqërisë së re “Ansig” sh.a do të konsistojë në klasat e Jo-Jetës.

Në përgjithësi vërehet një rritje e volumit të aktivitetit licencues të AMF-së në drejtim të profesionistëve, ndërmjetësve apo ofruesve të shërbimeve dhe:

- Në tregun e sigurimeve janë licencuar 162 agjentë, persona fizikë, nga të cilët 67% të licencuar për herë të parë; 7 vlerësues dëmsh, si dhe është tërhequr licenca e dy shoqërive të brokerimit “First Broker” sh.a dhe “Landes Broker” sh.a, duke bërë që numri i shoqërive të brokerimit të reduktohej nga 8 në 6. Gjithashtu, janë autorizuar 13 aktuarët e parë në

sigurime, pas përfundimit të trajnimit Aktuarial në Programin e Certifikuar, prej 16 modulesh të Aktuaristikës, program i organizuar nga FSVC. Fakulteti dhe Instituti i Aktuarëve, U.K. dhe Shoqata e Aktuarëve të Shqipërisë me mbështetjen e USAID-it dhe AMF-së. Licencimi i profesionistëve në fushën e sigurimeve gjithnjë ka patur si kriter të rëndësishëm kalimin me sukses të testeve profesionale të organizuara nga AMF, në funksion të objektivit për rritjen e aftësive profesionale të aplikantëve.

- Në tregun e titujve është licencuar një shoqëri brokerimi për veprimtarinë e shit blerjes së titujve me porosi të klientit, një broker fizik për llogari të saj, është autorizuar “Banka Societe Generale Albania” sh.a. për të vepruar si kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë dhe “Banka Credins” sh.a. për të vepruar si kujdestar i obligacioneve të shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore.

Në tregun e pensioneve vullnetare janë miratuar dhëniet e licencave të reja për të vepruar si shoqëri e administrimit të fondeve të pensionit vullnetar, për mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensioneve, si dhe kryerjen e pagesave të pensionit për “Shoqëria administruese e fondeve të pensionit vullnetar Sigal-Life” sh.a. dhe “Shoqërinë administruese të fondeve të pensionit SiCRED” sh.a.

Prania e kapitalit të huaj në shoqëritë e sigurimit përfaqësohet nga 3 aksionarë të huaj dhe gjatë vitit Autoriteti miratoi pjesëmarrjen influencuese të aksionarit “Vienna Insurance Group” në masën 75% + 1 aksion në shoqërinë e sigurimit “Intersig” sh.a.

Gjatë vitit 2011, Autoriteti ka miratuar ndryshime apo riemërime në përbërjen e këshillave mbikëqyrës në gjashtë shoqëri sigurimi, emërime në organet drejtuese të tri shoqërive të sigurimit, si edhe ndryshimet statutoare të shoqërive të sigurimit në lidhje me ndryshimin e madhësisë së kapitalit, e strukturës aksionare apo të hartimit të statuteve të reja.

Rritja e vëllimit të aktivitetit licencues pasqyron prirjen për zhvillim sasior të tregut financiar jo-bankar.

AMF është anëtare e 3 shoqatave ndërkombëtare të mbikëqyrësve të sigurimeve (IAIS), letrave me vlerë (IOSCO) dhe pensioneve (IOPS) dhe ka marrëdhënie e bashkëpunim të ngushtë me një numër të madh rregullatorësh në botë.

Forcimi i bashkëpunimit me institucionet homologe në rajon dhe institucionet brenda vendit, ka qenë një tjetër drejtim i rëndësishëm në drejtim të përmbushjes së rolit rregullativ të AMF-së, për një mbikëqyrje sa më efektive të tregjeve financiare jo-bankare.

- *Në tetor 2011, në Tiranë, si bashkëpunim i AMF-së me Autoritetin Hungarez të Mbikëqyrjes Financiare, u zhvillua takimi i dytë rajonal i mbikëqyrësve të tregjeve të sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore. Kjo iniciativë, e iniciuar në prill të vitit 2011 nga Autoriteti i Tregut Financiar Austriak dhe Autoriteti Hungarez i Mbikëqyrjes Financiare, mbledh së bashku Autoritetet Mbikëqyrëse të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, me qëllim promovimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve të ngushta të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit mes mbikëqyrësve të sigurimeve në rajon.*
- *Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Shkëmbimit të Informacionit, midis AMF-së, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit në mars 2011, mundëson kontrollin e zbatimit të legjislacionit për sigurimin e detyrueshëm, evidentimin e saktë dhe pajisjen e mjeteve motorike që lëvizin në territorin e Republikës së Shqipërisë me kontrata sigurimi të vlefshme, zvogëlimin e numrit të mjeteve të transportit të pasiguruara, kontrollet e përbashkëta dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të qarkullimit të mjeteve motorike.*

Të nderuar deputetë,

AMF, gjatë vitit 2011, ka punuar në mënyrë të pandërprerë në përmbushje të rolit të saj themelor: *Mbrojtjes së konsumatorit.*

Ky objektivi realizohet përmes **komunikimit efektiv me publikun**, informimit të vazhdueshëm të konsumatorit, krijimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të procedurave dhe praktikave të trajtimit të ankesave të konsumatorëve, rritjes së

vazhdueshme të cilësisë së informacionit dhe transparencës, duke inkurajuar dhe rritur besimin e publikut në tërësi në rolin e AMF-së.

Një mjet efikas në mbrojtje të interesave të konsumatorit është funksionimi pranë AMF-së, i njësisë së mbrojtjes konsumatore. Kjo njësi trajton ankesat për të gjitha rastet që paraqiten si për vonesat në trajtimin e dëmeve ashtu dhe për ankesa ndaj refuzimit apo masës së dëmshpërblimit.

Gjatë vitit 2011, kjo njësi ka trajtuar 59 ankesa në lidhje me funksionimin e sistemit të dëmshpërblimit që rrjedh nga kontratat e sigurimit.

Gjatë vitit 2011, është përdorur me efikasitet dhe numri jeshil në shërbim të konsumatorit. Nëpërmjet këtij shërbimi konsumatorit i është ofruar asistencë e vazhdueshme, kryesisht për produktet e ofruara nga shoqëritë e sigurimit apo dhe është bërë i mundur regjistrimi i ankesave në lidhje me ofrimin e produkteve të caktuara. Gjithashtu, Autoriteti në faqen zyrtare në Internet, i ofron çdo personi të siguruar mundësinë për të verifikuar nëpërmjet Qendrës Kombëtare të të dhënave të sigurimit të detyrueshëm MTPL, vlefshmërinë e policës së tij të sigurimit.

AMF përdor një larmi formash dhe metodash për të arritur një komunikim sa më efektiv me publikun, ku mund të përmendim fletëpalosjet, buletinet mujore informuese për të tre tregjet, botimet periodike vjetore, komunikimi nëpërmjet faqes zyrtare të Internetit, si edhe prezantimet në shtypin e shkruar dhe daljet e drejtpërdrejta në median vizive.

Publikimet e ndryshme me karakter informativ dhe edukativ, kanë synuar njohjen e konsumatorëve me tregun financiar jo-bankar dhe mënyrën e funksionimit të tij.

Viti 2011 ka qenë vit aktiv për AMF-në në pasqyrimin e aktivitetit të saj në median e shkruar dhe elektronike. Media e shkruar dhe elektronike ka shërbyer gjithashtu për të përcjellë publikut mesazhin e AMF-së, në funksion të fushatave sensibilizuese në drejtim të mbrojtjes dhe ndërgjegjësimit të konsumatorit.

Publikimi i projekteve ligjore në proces në faqen zyrtare të AMF-së, para miratimit të tyre, ka rezultuar një mënyrë efikase dhe transparente komunikimi në mbledhjen

e komenteve dhe sugjerimeve të ndryshme nga të gjitha palët e interesit dhe publikut të gjerë. Në dhjetor të vitit 2011, Autoriteti publikoi në faqen zyrtare projektligjin “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” me qëllim, forcimin dhe zhvillimin e sektorit të sigurimeve në vend. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe komunikimit me palët e interesit duke u prezantuar atyre reformat dhe strategjitë me ndikim të pritshëm në tregje.

Të nderuar deputetë,

më lejoni të paraqes përpara jush në mënyrë të përmbledhur edhe disa çështje që kanë të bëjnë me, **forcimin e kapaciteteve institucionale të AMF-së**. Autoriteti vazhdon të funksionojë sipas strukturës dhe organikës së miratuar në bazë të Vendimit nr. 98, datë 30.04.2007 si dhe kuadrit ligjor ekzistues. Organika e AMF-së e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë është 58 punonjës dhe mbetet e nevojshme që në bazë të VKM-së përkatëse, të miratohen edhe kategoritë e specialistëve, gjë që ende nuk ka ndodhur. Ky është një aspekt për të cilin kërkojmë mbështetjen tuaj. Jo vetëm kaq, por AMF e ka të domosdoshme që Kuvendi të mbështesë propozimin që bën AMF në lidhje me rregullimet organizative. Rregullimet organizative AMF i propozon, bazuar në nevojën për të mbikëqyrur tregun financiar jo-bankar, si dhe të përvojave të autoriteteve të tjera homologe. Natyra e veçantë e kësaj veprimtarie e bën akute që të kuptohen dhe të mbështeten këto veçanti, pa kërkuar unifikim me rregullimet organizative të strukturave të administratës shtetërore.

Nga ana tjetër, prej vitit 2009, AMF e financon aktivitetin tërësisht nga burimet e veta. Megjithatë, vijojnë të jenë në fuqi kufizimet mbi strukturën dhe sistemin e pagave, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në kapacitetet, efektivitetin dhe rritjen e ekspertizës së AMF-së. Këto kufizime ulin mundësinë e absorbimit të ekspertëve aq të pakët në këtë profil dhe unë shpresoj që më së fundi kjo çështje thelbësore për funksionimin e AMF-së të gjejë vëmendjen dhe trajtimin tuaj. Situata është disi më problematike, pasi AMF po ballafaqohet me largime punonjësish me përvojë dhe dinamikë, sidomos të punonjësve të angazhuar në sektorët e aktuaristikës dhe të analizës së tregjeve.

Në negociatat për anëtarësimin në BE, pjesë e të cilave është edhe AMF për kapitullin 9 të shërbimeve financiare, është theksuar nevoja e forcimit të kapaciteteve administrative të AMF-së dhe e rritjes së numrit të punonjësve. Misionet e asistencës së Bankës Botërore gjithashtu kanë vënë theksin në nevojën e forcimit të pavarësisë së AMF-së, sidomos të pavarësisë financiare të tij për të tërhequr, mbajtur dhe trajnuar në vijimësi punonjës të aftë profesionalisht dhe me integritet.

Për të kapërcyer këto probleme, AMF kërkon mbështetjen e Kuvendit dhe të deputetëve të nderuar, si për respektimin e kërkesave në lidhje me rregullimet organizative të saj ashtu edhe për kryerjen e ndryshimeve të nevojshme të ligjin e AMF-së me synim forcimin e pavarësisë dhe krijimit të një mekanizmi ligjor për mbrojtjen e saj.

Të nderuar deputetë,

zhvillimet e deritanishme në AMF, konsolidimi i vazhdueshëm i këtij institucioni, si dhe nevoja për të udhëhequr zhvillimin e tregjeve financiare jo-bankare e vë AMF-në gjithnjë përballë sfidave të rëndësishme. Nga ana tjetër, duke e kombinuar me ndryshimet që po ndodhin në industrinë mbikëqyrëse e rregullatore si pasojë e krizës financiare globale, është më se e qartë që vëmendja jonë kërkohet të jetë mbi cilësinë dhe integritetin e procesit mbikëqyrës. Objektivat e përcaktuara për këtë vit janë po aq ambiciozë dhe konsistojnë në:

Rritja e cilësisë dhe efektivitetit të procesit mbikëqyrës përbën një objektiv pothuaj të përhershëm të AMF-së, i cili përmbushet si gjatë përmirësimit të procesit ditor mbikëqyrës, ashtu edhe nga ideimi e zbatimi i një sërë projektesh, kryesisht të natyrës afatmesme.

Në vitin 2012 prioritetet kanë të bëjnë me (i) Futjen në zbatim të Sistemit të Administrimit të Informacionit; (ii) Mirëmbajtjen dhe administrimin e infrastrukturës hardware dhe software; (iii) Përmbushjen e detyrave sipas Planit Strategjik të Zbatimit të metodologjisë me fokus riskun për tregun e sigurimeve. Përmbushja e objektivit ka në themel një kërkesë mjaft të rëndësishme: aftësimin profesional të punonjësve të AMF-së.

Përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor e rregullativ përbën një tjetër objektiv të rëndësishëm dhe afatgjatë për AMF-në duke qenë se lidhet me shtyllën e dytë të funksionit të saj, rregullimin. Duke ndjekur këtë objektiv synohet që (i) kuadri ligjor e rregullativ t’i përafrohet direktivave të BE-së, duke kontribuar në këtë mënyrë në procesin e integritit të vendit në BE; (ii) kuadri ligjor e rregullativ t’i përafrohet standardeve ndërkombëtare të shpallura për mbikëqyrjen e tregjeve financiare jo-bankare; (iii) të adresohen gjithnjë e me mirë nevojat e brendshme të tregut dhe specifikat e tij.

Forcimi i pavarësisë dhe transparencës së AMF-së përbën një objektiv që është risjellë në vëmendje të Autoritetit. Parimet ndërkombëtare të mbikëqyrjes së tregjeve financiare gjithashtu përmbajnë një sërë kërkesash mbi autoritetin, kompetencat dhe fuqinë e zbatueshmërisë të institucioneve mbikëqyrëse e rregullatore. Të gjitha këto elemente konvergojnë në objektivin e forcimit të pavarësisë institucionale të AMF-së dhe krijimin e garancive për ruajtjen e saj në të ardhmen. Në këtë kuadër gjatë vitit 2012 do të hartohen edhe ndryshime të reja në Ligjin “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

Rritja e transparencës së AMF-së është një objektiv i iniciuar së brendshmi për të kontribuar në rritjen e efektshmërisë së procesit mbikëqyrës. Në këtë aspekt pritet që të shtohet informacioni që i transmetohet publikut duke e thjeshtuar dhe bërë atë më të kuptueshëm edhe për lexuesin joprofesionist; të shtohen kontaktet me median; të rritet vetëdijësimi i konsumatorëve, si dhe të shtohet komunikimi me publikun ekspert për çështjet e kryerjes së veprimtarisë kërkimore dhe diskutimit të saj.

Rregullimi efektiv i tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik përbën një nga sfidat kryesore të institucionit, që prej krijimit të tij. Ky objektiv merr përparësi në kushtet e heqjes me ligj të regjimit të tarifave fikse në sigurimin e detyrueshëm motorik. Kështu, në shtator të vitit 2011, filloi zyrtarisht projekti që do të asistojë AMF në orientimin e drejtë të procesit të liberalizimit me objektiv zhvillimin e politikave dhe proceseve drejt tarifimit me bazë riskun të produkteve të sigurimit të detyrueshëm motorik dhe përafrimin e kuadrit aktual ligjor që rregullon sigurimin e detyrueshëm motorik me direktivat e BE-së.

Zhvillimi teknologjik për të mbështetur aktivitetin mbikëqyrës përmban një sërë detyrash ambicioze duke patur parasysh burimet e kufizuara në dispozicion.

Në harmoni me strategjinë e tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik, për projektin e përgjithshëm të Qendrës Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, për vitin 2012, janë parashikuar ndryshime në Regjistrin Elektronik Online të shitjeve të sigurimeve të detyrueshme motorike; në Regjistrin e Dëmeve që do të ndihmojnë në aplikimin e masave të rregullimit efektiv të tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik. Gjithashtu do të vazhdojë zgjerimi i “Sistemit SMS i mbështetjes së Konsumatorëve”.

Në vitin 2012 AMF do të drejtohet nga Bordi i përbërë prej anëtarëve, të cilët u miratuan në Kuvend në periudhën shtator-dhjetor 2011. Me këtë rast, në emër të institucionit, dua të falenderoj Bordin e AMF-së, që e ka drejtuar atë për periudhën 5-vjeçare, nga krijimi i tij. Është vizioni dhe përkushtimi i tyre, si dhe i krejt personelit, që mundësuan konsolidimin pa probleme të tri autoriteteve paraardhëse dhe hapjen e rrugës për zhvillimin e tij. Më lejoni që në mënyrë të veçantë të shpreh vlerësimin dhe mirënjohjen për punën dhe përkushtimin në drejtimin e AMF-së të kryetares së Bordit, znj. Elisabeta Gjoni, vizioni i së cilës është mishëruar në një pjesë të konsiderueshme të projekteve më madhore të institucionit.

Gjithashtu, shpreh vlerësimin për punonjësit e AMF-së të cilët përballojnë një punë të konsiderueshme dhe gjithnjë bëjnë përpjekje për rritjen e cilësisë. Si drejtuese e institucionit më lejoni të risjell në vëmendjen tuaj mbështetjen që besojmë se Kuvendi do të duhet t’i japë AMF-së për të mundësuar funksionimin në bazë të kriterëve ndërkombëtare të përcaktuara për autoritetet rregullatore dhe krijimin e hapësirave për forcimin e integritetit të punonjësve dhe integritetit institucional.

Ju falenderoj për vëmendjen tuaj.

Enkeleda SHEHI

KRYETAR